

URDHËR
Nr. 11, datë 1.2.2024

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.4.2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik” dhe udhëzimin nr. 4, datë 29.1.2020, “Për delegimin e të drejtave dhe detyrave në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Agjencisë së Zhvillimit të Territorit, për nisjen dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit për blerjet me vlera të vogla apo direkte te drejtori i Drejtorisë GIS, z. Endri Bala.
2. Kompetenca e deleguar sipas pikës 1 të këtij urdhri, do të ushtrohet nga data e hyrjes në fuqi e këtij urdhri deri më datë 31.3.2024.
3. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri, drejtori i Drejtorisë GIS, z. Endri Bala.
Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Adelajda Roka